

VETËM NJË NUMËR I VOGËL I NXËNËSVE VIJOJNË MËSIMIN NË KLASË – NJË NUMËR I OBJEKTEVE SHKOLLORE MBYLLEN GJATË KOHËS SË LIGJIT PËR MASA EMERGJENTE

Duke filluar nga dita e marte 14.4 në Vantaa do të mbylLEN 23 objekte shkollore. Vazhdojnë të jenë të hapura 30 shkolla tjera, në të cilat do të vijojnë mësimin edhe nxënësit e objekteve shkollore të mbyllura. Mundësia e infektimit do të minimizohet me bashkimin e objekteve vepruese shkollore. Mësimin e nxënësve do ta organizojmë në grupe deri në 10 nxënës nëpër hapësira të ndryshme të objektit shkollor, do kujdesemi që kontakte të afërta të ketë mundësishtë sa më pakë. Grupet e mëparshme të mësimit klasor mbesin të njëjtat dhe për mësimin e nxënësve do të kujdesen personeli mësimor i shkollës. Koha e ushqimit dhe pushimi mes orëve do të shkurtohen. Nxënësit me mësim nga distanca vazhdojnë mësimin normalisht.

Gjatë kohës së ligjit për masa emergjente ju preferojmë nxënësve sipas urdhëresave të këshillit shtetror që sa më shumë të marrin pjesë në procesin mësimor përmes mësimin nga distanca. Ndërsa nxënësit e mësimin në klasë sipas nevojës mund të vijojnë mësimin në klasët 1.-3. si dhe në klasët 1.-9. me nxënës për mësim të veçantë dhe nxënësit në përgatitje për vijimin e shkollimit. Të gjitha shkollat ku mësojnë persona me aftësi të kufizuara vazhdojnë veprimtarin e tyre.

Mësimin në klasa të shkollës në Vantaa gjatë kohës së ligjit të masave emergjente e kanë mbajtur gjatë ditës gjithësejtë rreth 400 nxënës. Kjo është më pakë se 2 përqind e të gjithë nxënësve të mësimin fillor dhe të mesëm të ulët nga 24 000 nxënës. Në shumicën e shkollave gjatë kohës së ligjit të masave emergjente mësimin në klasë nuk a kanë mbajtur asnjë nxënës ose vetëm disa prej tyre.

Numri i nxënësve do të mbetet në pakicë nëpër shkollat që qëndrojnë të hapura edhe pas bashkimit të tyre. Në bazë të informatave momentale në secilën nga shkollat e bashkuara do të mësonin më pakë se 40 nxënës për mësim në klasë. Mesatarja e nxënësve për shkollat në Vantaa është 545 nxënës, kështu që hapësirat e mëdha mundësojnë organizimin e lirshëm të mësimin poashtu edhe në objektin e njejtë.

Është e arsyeshme mbyllja e përkohëshme e atyre objekteve shkollore, nxënësit e të cilave banojnë në afërsi të një shkolle tjetër. Dhe në të njejtën kohë në shkollat e mbyllura do të mund të bëhet korigjimi i ajrosjes së mbrendëshme apo ndryshimet tjera, dhe se nuk do të ketë edhe shpenzime të panevojshme të mirëmbajtjes, të ushqimit, të rojes, të energjisë dhe të pastrimit të objekteve shkollore. Mbyllja e objekteve shkollore mundëson planifikimin e bërë për qershor 2020 për fillimin e punëve në korigjimin e ajrosjes së mbrendëshme dhe të ndryshimeve tjera tani kjo mund të fillohet në prill-maj. Kështu punët për korigjime

dhe ndryshime do të bëheshin dhe objektet do të ishin të gatëshme, atëherë kur puna në shkolla do të vazhdonte normalisht pas përfundimit të ligjit të masave emergjente.

Në vendimin për mbylljen e objekteve shkollore është pasur parasyshë, që udhëtimet deri te shkolla për nxënësit bazuar në moshën dhe zhvillimin e tyre të mos zgjaten. Për nxënësit e klasave 1.-4. bashkimi i shkollave të tyre mund të ketë pasoj një zgjatje të lehtë të rrugës deri në shkollë, dhe për klasat 5.-9. rruga deri në shkollë mund të zgjatet pakë më shumë.

Ndajmë keqëardhje për mundësin e ndikimeve negative të këtyre organizimeve.

Informata shtesë lidhur me këto organizime në shkolla merren nga drejtorët e shkollave tuaja. Drejtori sipas nevojë ju informon më saktësishtë për organizimin e mësimit në klasë përmes aplikacionit Wilma.

Përsëndetje miqësore

Ilkka Kalo, drejtor i mësimit fillor dhe të mesëm të ulët

Anders Vikström, drejtor për shërbime në gjuhën suedeze

SHKOLLAT QË MBYLLEN DUKE FILLUAR NGA DITA E MARTE 14.4:

Numri i nxënësve dihet pas situatës përfundimtare, kur objektet shkollore përkohësishtë mbyllen. Numri i nxënësve do të caktohet sipas gjendjes me 3.4.2020. Vlera në kllapa pas numrit të nxënësve tregon kapacitetin e shkollës me nxënës, pra informatë lidhur me atë, se sa nxënës në kushte normale mund të ketë shkolla.

Njësa shërbyese lindore (6 objekte shkollore)

Nga shkolla Lehtikuusi (klasët 1-9) Havu objekti dhe objektet mësimore në Harmotie barten në shkollën Lehtikuusi në objektin shkollor Kaarna.

- Për mësime në klasë 20 nxënës (600)

Nga shkolla Peltola (klasët 7-9) barten në shkollën në Jokiniemi

- Për mësime në klasë 31 nxënës (754)

Nga shkolla në Simonkallio (klasët 1-6) barten në shkollën në Hiekkaharju

- Për mësime në klasë 32 nxënës (649)

Nga shkolla në Simonkylä (klasët 5-9) barten në shkollën në Jokiniemi

- Për mësime në klasë 31 nxënës (794)

Nga shkolla në Sotungi (klasët 5-9) barten në shkollën Lehtikuusi në objektin Kaarna

- Për mësim në klasë 20 nxënës (700)

Shkolla Västersundoms bartet në shkollën Dickursby.

- Për mësim në klasë 0-5 nxënës (210)

Shkolla Kyrkobys bartet në shkollën Dickursby ose Mårtensdals sipas adresave të nxënësve

- Për mësim në klasë 0-5 nxënës (210 ose 250)

Njësia shërbyese perëndimore (9 objekte shkollore)

Në shkollën Hämeenkylä (klasët 1-9) nga objekti mësimor Sanomala bartet në shkollën në Martinlaakso.

- për mësim në klasë 20 nxënës (996)

Në shkollën Hämeenkylä (klasët 1-9) nga objekti mësimor Tuomela bartet në objektin mësimor Varisto në Hämeenkylä.

- për mësim në klasë 6 nxënës (100)

Nga shkolla Kannisto (klasët 1-6) barten në shkollën Aurinkokivi

- për mësim në klasë 20 nxënës (rr. 1 000)

Nga shkolla Kartanonkoski (klasët 1-9) barten në shkollën internacionale në Vantaa

- për mësim në klasë 38 nxënës (546)

Nga shkolla Kartanonkoski (klasët 1-9) nga objekti mësimor në Tammisto barten në shkollën internacionale në Vantaa

- për mësim në klasë 38 nxënës (546)

Nga shkolla Kilteri (klasët 7-9) barten në shkollën në Martinlaakso

- për mësim në klasë 20 nxënës (996)

Nga shkolla në Veromäki (klasët 1-9) barten në shkollën internacionale në Vantaa.

- për mësim në klasë 38 nxënës (546)

Nga shkolla në Veromäki (klasët 1-9) nga objekti mësimor Pakkala barten në shkollën internacionale në Vantaa

- për mësim në klasë 38 nxënës (546)

Nga shkolla në Veromäki (klasët 1-9) nga objekti mësimor në Riihipelto barten në shkollën internacionale në Vantaa

- për mësim në klasë 38 nxënës (546)

Njësia shërbyese verilindore (6 objekte shkollore)

Nga shkolla në Havukoski (klasët 6-9) barten në shkollën në Koivukylä

- Për mësim në klasë 12 nxënës (485)

Nga shkolla në Jokivarsi klasët (1-6) në objektin mësimor Sorvatie barten në objektin mësimor Nikinmäki në Jokivarsi

- Për mësim në klasë 11 nxënës (300)

Nga shkolla në Korso (klasët 6-9) barten në shkollën Leppäkorpi

- Për mësim në klasë 14 nxënës (rr. 400)

Nga shkolla në Mikkola (klasët 1-9) nga objekti shkollor Vega barten në objektin shkollor Lyyra në Mikkola

- Për mësim në klasë 11 nxënës (rr. 500)

Nga shkolla në Ruusuvuori (klasët 6-9) barten në objektin shkollor Lyyra në Mikkola

- Për mësim në klasë 11 nxënës (rr. 500)

Nga objekti shkollor Kulomäki në Vierumäki (klasët 1-5) barten në objektin shkollor Lehmustontie në Vierumäki

- Për mësim në klasë 17 nxënës (400)